



Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Dr. Bekim Gashi

Nr. i ref. 224/2016

Prizren, më 26.02.2016

Në bazë të kompetencave të Këshillit Drejtues të cilat janë konform Ligjit Nr. 04/L-37 të dt. 29.08.2011 neni 18 paragrafi 1 si dhe dispozitave të nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të UPZ-së Nr. 04-V-621 dt. 30 maj 2013 si dhe në mbështetje të nenit 11 të Rregullores për zgjedhjet Studentore në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 26.02.2016, njëzëri miratoi këtë dokument si në vijim;

## DINAMIKA E PROCESIT ZGJEDHOR NË UNIVERSITETIN "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN

- 1) Dinamika e procesit zgjedhor për zgjedhjet studentore të Parlamentit të Studentëve dhe Këshillat e Studentëve në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren është bazuar në Vendimin mbi shpalljen e zgjedhjeve studentore, Konform Ligjit Nr. 04/L-37 të dt. 29.08.2011 si dhe të Statutit të UPZ-së Nr. 04-V-621 dt. 30 maj 2013 si dhe Rregullores për zgjedhjet Studentore në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.
- 2) Obligohen të gjitha organet udhëheqëse të Universitetit duke e përfshirë edhe Komisionin Zgjedhor që t'i përmbahen me përpikëri të gjitha afateve të përcaktuar në këtë dokument.
- 3) Për zbatimin e kësaj dinamike përgjegjësën e mbikëqyrjes e ka Këshilli Drejtues.

### ➤ Shpallja e fillimit të procesit zgjedhor më 29.02.2016

Nr.	PËRMBAJTA	DATA
1.	Publikimi i vendimit për shpalljen e zgjedhjeve studentore dhe materialeve tjera	29.02.2016
2.	Konstituimi i KQZ	04.03.2016
3.	Regjistrimi i Organizatave Studentore në Sekretarinë e Universitetit dhe KQZ	07.03 – 18.03.2016
4.	Certifikimi i Organizatave Studentore nga KQZ	21.03 – 25.03.2016
5.	Tërheqja e shortit për numrat e secilës Organizatë studentore të certifikuar nga KQZ që marrin pjesë në zgjedhje	28.03.2016
6.	Shpallja e listës së studentëve / listës preliminare me të drejtë vote, verifikimi dhe miratimi i tyre në KQZ	31.03 – 08.04.2016
7.	Periudha e ankesave ndaj listës preliminare të miratuar nga KQZ	11.04 – 15.04.2016
8.	Shpallja e listës përfundimtare të studentëve me të drejtë vote nga KQZ	18.04 – 22.04.2016

9.	Përgatitja e materialit zgjedhor, fletëvotimeve, materialit zgjedhor, procesverbaleve dhe rregullimi i vendvotimeve	22.04 – 06.05.2016
10.	Fushata zgjedhore e Organizatave Studentore	25.04 – 15.05.2016
11.	Dita e mbajtës së zgjedhjeve	17.05.2016
12.	Shpallja e rezultateve preliminare	18.05.2016
13.	Shpallja e rezultateve përfundimtare	23.05.2016
14.	Periudha e ankesave	Sipas rregullores

*Ky dokument hyn në fuqi me nënshkrimin nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues*

I'u dërgohet:

1. Menaxhmentit;
2. Këshillit Drejtues;
3. Zyrës Ligjore;
4. Parlamentit të Studentëve;
5. Arkivit.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
~~Dr. Bekim Gashi~~

